

VENDIM
Nr. 41, datë 1.6.2018

PËR LICENCIMIN E UJËSJELLËS-KANALIZIME SHA FINIQ
(ndryshuar me VKM nr. 141, datë 27.11.2020)

Në zbatim të nenit 14, pika 1/“a”, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe të rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq për licencim për herë të parë, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq ka aplikuar pranë ERRU-së për licencim për herë të parë, me shkresën me nr. prot. 245, të datës 23.4.2018, për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të ndotura.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq është themeluar në datën 26.7.2017, si një shoqëri aksionare, me një nivel administrimi në pronësi të Bashkisë Finiq, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”. Kjo shoqëri është regjistruar në QKB në datën 31.7.2017, me NUIS: L76931502F.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq i shërben pjesërisht Bashkisë Finiq, pasi 9 (nëntë) fshatra furnizohen me ujë nga Ujësjiellës-Kanalizime Sarandë sh.a., ku Bashkia Finiq zotëron 37.5% të kësaj shoqërie.

- Asambleja e përgjithshme e UK Sarandë, me vendimin nr. 1, datë 24.4.2017, ka vendosur fillimin e procedurave për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, me vlerën e aktiveve materiale (grupi i objekteve) që i transferohen Bashkisë Finiq.

- Në dosjen e aplikimit mungonte dokumenti i aktmiratimi higjieno-sanitar, ndërkohë që ishte sjellë vetëm raportanaliza e burimeve nga Drejtoria e Shëndetit Publik. Dosja u plotësua në datën 5.5.2018.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Finiq sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit për licencim për herë të parë, konkretisht:

- Format i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Për dokumentin “Ekstrakti historik i Regjistrat Tregtar”, në të cilin ende nuk janë reflektuar ndryshimet sipas riorganizimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq detyrohet të paraqesë pranë ERRU-së ekstraktin e QKB-së të përditësuar menjëherë pas përfundimit të procesit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq, me:

Drejtues ligjor: *Mihal Çavo*

Drejtues teknik: Foto Thanasi

2. Operatori Ujësjellës-Kanalizime sh.a. Finiq autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zonat e shërbimit të këtij operatori janë njësitë administrative të Bashkisë Finiq, si më poshtë:

a) Finiq (përveç fshatit Vrion);

b) Aliko (përveç fshatrave Aliko, Çaush, Neohor, Tremul);

c) Dhivër (përveç fshatit Navaricë);

d) Mesopotam (përveç fshatrave Livinë, Fitore, Krane, Ardhasovë);

e) Livadhja.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani